

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Nr. 164, 167, 171 Regj.

Nr. 89 Prot.

Tiranë më 17.03.2022

Lënda: Mbi shkresën tuaj Nr. 6318/1 Prot. datë 15.03.2022

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë



Të nderuar,

Në vijim të shkresës tuaj Nr. 6318/1 Prot. datë 15.03.2022 dhe komunikimeve të mëparshme, cmojmë të arsyeshme t'ju informojmë sërish se:

1. Pranë “Zyrë e Përmbarrimit Privat Tirana Bailiff’s” sh.p.k. bazuar në Vendimin “Për Lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimi” Nr. 2847 Akti datë 06.05.2021, Vendimin “Mbi Lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimi” Nr. 7602 Akti datë 19.07.2021, dhe Vendimin “Për Lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimi” Nr. 7601 Akti datë 29.09.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këto Urdhëra, duke regjistruar në dosjet përmbarrimore Nr. 164, 167, 171 Regj., kërkesën e kreditorit “Raiffeisen Bank” sh.a ndaj debitorëve Shoqëria “Lubima” sh.p.k. me NIPT K96419401J; debitor Shoqëria “New Pellet” sh.p.k. me NIPT L77422401C, dorëzanësve Shkëlqim Nexhat Keshi i dtl 25.07.1974, Luan Bilal Manjani i dtl 08.05.1959, dhe hipotekuesit Zare Bilal Keshi e dtl 28.05.1949, lëshuar për titujt ekzekutiv, Kontratë Kredie me Kufi Nr. 576 Rep., Nr. 210 Kol. datë 22.05.2018, e ndryshuar, Kontratë Kredie me Kufi me Nr. 575 Rep., Nr. 209/2 Kol. datë 22.05.2018, e ndryshuar dhe Kontratë Kredie me Kufi Nr. 577 Rep., Nr. 211/2 Kol. datë 22.05.2018, e ndryshuar.

2. Për sa i përket kuotave të dorëzanësit, të ndjerit, Luan Manjani, bazuar në Nenin 341 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, mbi pagimin e detyrimeve, “Trashëgimtarët përgjigjen për detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore në përpjesëtim me pjesët e tyre, gjer në vleftën e pasurisë trashëgimore që kanë marrë...”
Në këtë rast, trashëgimtarët e dorëzanësit, të ndjerit, Luan Manjani, do të përgjigjen për detyrimet e dorëzanësit (të ndjerit), në masën që ata kanë trashëguar.

Në këto kushte, për sa më sipër, konfirmojmë vënien e sekuestros conservative, rrjedhimisht edhe mbi trashëgimtarët e dorëzanësit (të ndjerit) Luan Manjani, për pjesën e kuotave që kanë trashëguar nga Luan Manjani tek Shoqëria Lubima sh.p.k. NIPT K96419401J.

“Zyrë e Përmbarrimit Privat Tirana Bailiff’s” sh.p.k.
PËRMBARUES GJYQËSOR
NATASHA LASKA

